



Lëvizja me biçikletë në Gjermani -  
Rregullat më kryesore

SHQIP



## Mirëseerdhët në Gjermani

Lëvizja me biçikletë preferohet shumë edhe në Gjermani.

Që ju të orientoheni në mënyrë sa më të sigurt me biçikletë në qarkullimin rrugor në Gjermani, ne kemi përmbledhur për ju në këtë broshurë rregullat më të rëndësishme të të sjellurit në trafik.

# Përmbajtja

Biçikleta e përshtatshme për rrugë	6-7
Rregullat e përgjithshme të trafikut	8-9
Korsitë për drejtuesit e biçikletave	10-13
Sjellja e duhur në kryqëzime	14-15
Rreziqet e veçanta	16-17
Ju lëvizni me një pedelec	18-19
Informacione dhe materiale të tjera	20

# SHQIP





## Ju ecni me biçikletë



Në parim, për ata që ngasin biçikletën vlejnë **të njëjtat rregulla në trafik si edhe për drejtuesit e automjeteve.**

(Rregullat e të drejtës së kalimit, rrugët me një drejtim, semaforët...)

# Biçikleta e përshtatshme për rrugë

Një biçikletë duhet të ketë ndriçim, frena dhe një zile.

Vetëm një person lejohet të jetë i hy-pur në biçikletë.

Dy frena të pavaruara nga njëra-tjetra (përpara dhe mbrapa)

Zile me tingull të lehtë

Reflektor (i bardhë)  
Prozhektorët (e bardhë)

Reflektori në sipërfaqe të madhe (në ngjyrë të kuqe dhe drita e pasme (e kuqe)

Dy reflektorë të verdhë për çdo pedal

Dinamo ose dinamo qendër

Dy reflektorë me sy mace (për çdo rrotë), shirita reflektor ose reflektorë me fole (të verdhë)

Reflektor i vogël (i kuq)



## Rregullat e përgjithshme të trafikut



### TRAFIKU NË TË DJATHTË

Në Gjermani, zakonisht zbatohet ngarja e mjetit në krah të djathtë. Prandaj, ngiteni biçikletën në anën e djathtë të rrugës. Ruani mjaftueshëm distancën me automjetet që parkojnë. Ekziston rreziku i një dëre makine që hapet dhe që mund t'ju prekë juve. Automjetet e tjera parakalojnë gjithmonë majtas, madje edhe në rrugët e dedikuara për çiklistët.



### RREGULLI I PËRPARËSISË

#### „DJATHTAS PËRPARA MAJTAS“

Në kryqëzime zbatohet rregulli i të drejtës së kalimit “djathtas përpara majtas”, përveç rasteve kur nuk ka tabela trafiku ose kur ka semaforë që tregojnë të kundërtën. Kjo do të thotë që personat, që vijnë nga e djathta, duhet të kalojnë të parët.

Udhëkryqet ose kryqëzimet që janë të vështira për t'u identifikuar janë të shënuara posaçërisht dhe rregulli “djathtas përpara majtas” vlen edhe këtu.

Jepni të drejtën e kalimit



Ndal! Jepni të drejtën e kalimit



### SHENJAT E PARAKALIMIT

Në rastin e këtyre shenjave në trafik ju duhet t'i jepni të drejtën e kalimit automjeteve të tjera dhe të prisni.



E drejta e kalimit Rruga e përparësisë



Në rastin e këtyre shenjave në trafik duhet që drejtuesit e tjerë t'ju japin juve të drejtën e kalimit.

### **RREGULLAT PËR DREJTUESIT E BIÇIKLETAVE:**

- Në biçikletë duhet të ketë hypur vetëm një person.
- Mbajini të dyja duart në timon.
- Mundësisht lëvizni njëri pas tjetrit me biçikletë.
- Mbani gjithmonë një kaskë kur ngisni biçikletën. Ajo mund t'ju ruajë nga dëmtime të rënda në kokë.
- Drejtuesit e biçikletave nuk duhet të shkojnë pas mjeteve të tjera
- Ata duhet të respektojnë rregullat e qarkullimit. Edhe drejtuesit e biçikletave ndalohen nga policia dhe marrin gjoba.
- Mos flisni në telefon kur jeni duke ecur me biçikletë dhe mos shikoni në celularin tuaj.
- Mos lëvizni me biçikletë kur keni pirë alkool.
- Jini gjithmonë gati për të frenuar në hyrje dhe në dalje të rrugës.
- Kujdes: Kamionët për pak mund të mos ju shohin, prandaj ngiteni biçikletën ose qëndroni gjithmonë mbrapa tyre.
- Fëmijët e vegjël lejohet të jenë të hipur në biçikletë vetëm në ndenjësjet e fëmijëve ose në rimorkio speciale.





## Korsitë për çiklistët



Biçikleta është një mjet lëvizës dhe në parim edhe ajo është pjesë e rrugës. Fëmijët deri në moshën 8 vjeç duhet ta ngasin biçikletën në trotuar. Deri në moshën 10 vjeç fëmijët lejohet ta përdorin akoma trotuarin.

Për të gjithë të tjerët ngarja e biçikletës në trotuar është e ndaluar; kjo vlen edhe për prindërit që shoqërojnë fëmijët e tyre.

**Vija për çiklistët** shënohet në rrugë me një vijë të bardhë të pandërprerë dhe me shenjën blu të korsisë së çiklizmit. Kjo nuk lejohet të kalohet nga automjetet.

Një **korsi për biçikleta** ndahet nga rruga nëpërmjet një bordure dhe nga trotuari nëpërmjet shenjimeve, shtrimit ose një bordure më të ulët.

Korsia e çiklistëve/  
Vizat për çiklistët





**Vija mbrojtëse** është e shënuar në rrugë me një vijë të ndërprerë dhe me një piktogram për biçikleta. Ajo lejohet të kalohet nga automjetet vetëm, kur këtyre u duhet të devijojnë trafikun në krahtë të kundërt.

Gjithashtu ka edhe **korsi të përbashkëta për kalimtarët dhe çiklistët**. Çiklistët duhet të udhëtojnë në korsinë e biçikletave (ndalim i rrugës) Ata duhet ta ndajnë rrugën me njerëzit që ecin në këmbë.

Prandaj: Respektoni këmbësorët dhe në rast nevojë bjerini ziles për të kaluar përmes.



Korsia e përbashkët  
për këmbësorët  
dhe çiklistët



Korsia e biçikletave



Korsia e përbashkët për këmbësorët dhe çiklistët



Korsia e biçikletave afër një korsie këmbësorësh

### KËTU DUHET TË KALOJNË ÇIKLISTËT:

Sapo një korsia për biçikleta të shenjohej me një biçikletë të bardhë në një sfond blu, ju duhet ta përdorni atë nëse nuk ka pengesa në rrugë. Atëherë mund të shmangeni me kujdes në rrugë. Nëse nuk është e mundur të kaloni me siguri në rrugë, duhet të zbrisni dhe ta shmangni pengesën duke e shtyrë biçikletën.

Korsitë e biçikletave pa sinjalistikë mund, por nuk duhet të përdoren. Këtu mund të kaloni edhe në rrugë me biçikletë.

### KËTU ÇIKLISTËT LEJOHEN TË KALOJNË:

Sipërfaqet e tjera (p.sh. trotuar, zona e këmbësorëve) mund të kalohen vetëm, nëse janë të shenjua me një tabelë shtesë “Ecja me biçikletë e lirë” ose “Ecja me biçikletë në të dy drejtimet”.





**Korsitë e shpejta të biçikletave** u mundësojnë çiklistëve lidhje të drejtpërdrejta dhe një shpejtësi të lartë në kalim.



Parimisht nuk lejohet asnjë qarkullim tjetër në zonat e biçikletave, përveç automjeteve të vogla elektrike.



Në rrugët që kanë këtë tabelë nuk duhet të kalohet.



Pa tabelën shtesë "Ecja me biçikletë e lirë", ju duhet të zbrisni nga biçikleta dhe ta shtyni atë me dorë.

### KËTU ÇIKLISTËT NUK DUHET TË ECIN ME BIÇIKLETË:

Rrugë automobilistike



Autostradë



Trotuar



Ndalim për mjetet e çdo lloji



Ndalim qarkullimim për biçikletat





## Sjellja e duhur në kryqëzime




### SEMAFORI

Edhe kur jeni në biçikletë duhet t'i respektoni semaforët.

Nëse ekzistojnë semaforë të veçantë për biçikleta, duhet t'i respektoni këto.

Ngandonjëherë ka edhe semaforë të kombinuar për ata që ngasin biçikletën dhe për ata që ecin në këmbë.



**Me ngjyrën jeshile** ju lejohe të kaloni. Por qëndroni të vëmendshëm.

**Me ngjyrën e verdhë** nuk lejoheni më, që të kaloni në kryqëzim. Qëndroni.

**Stop! Me ngjyrë të kuqe** duhet të qëndroni gjithmonë. Ndalimi i detyrueshem

Ngandonjëherë, për shembull kur semafori është prishur, është policia ajo që e rregullon trafikun. **Shenjat me dorë të policëve kanë gjithmonë përparësi.**

#### Të dy krahët poshtë:

Tani lejohe të kaloni. Por qëndroni të vëmendshëm.

#### Njëri krah sipër, tjetri poshtë:

Kujdes! Përpara kryqëzimit prisni për shenjën tjetër.

#### Krahët e hapura djathtas dhe majtas:

Stop!



## KUJDES KUR MERRNI KTHESËN

Kështu mund ta merrni kthesën në mënyrë të sigurt:

### 1. Vështrimi nga shpatullat:

Në fillim vështroni nga shpatullat dhe vëzhgoni trafikun.

### 2. Jepni shenjat me dorë:

Tregoni në mënyrë të qartë me krah se për nga do ta merrni kthesën.

### 3. Pozicionohuni

Nëse ka një rrugë biçikletash, ndiqni atë.

Vendosuni në kohën e duhur para kryqëzimit në korsinë përkatëse të biçikletave.

### 4. Marrja e kthesës:

Kur ktheheni djathtas respektoni personat që ecin në këmbë, të cilët njëkohësisht janë duke kaluar rrugën, pasi këta kanë përparësi. Ku ktheheni majtas duhet t'i lini gjithmonë të kalojnë në mjetet që vijnë nga drejtimi i kundërt. Nëse ka një shenjim të veçantë për çiklistët, ndiqni atë.

### 5. Shigjeta jeshile për çiklistët:

Në semaforët me shigjetë jeshile për qarkullimin me biçikleta kthimi djathtas pas qëndrimit është i lejuar edhe me dritë të kuqe.



## MARRJA E KTHESËS JO DREJTPËRDREJTË

Nëse në momentin e marrjes së kthesës majtas ndiheni të pasigurt në rrugë, ju mund të ktheheni majtas edhe në mënyrë të tërthortë:

1. Në fillim kaloni drejt në kryqëzim.
2. Qëndroni në anë të korsisë së djathtë, sipas rastit duhet të zbrisni nga biçikleta.
3. Prisni derisa rruga të jetë e lirë.

Më pas kaloni rrugën dhe vazhdoni të ecni me biçikletë.



## Rreziqe të veçanta



### “KËNDI I VDEKUR”

Çiklistët janë tepër të rrezikuar, kur kamionët ose makinat private kthehen nga ana e djathtë. Në të ashtuqajturin kënd të vdekur shoferi i kamionit ju sheh shumë keq ose aspak.

Ecni në mënyrë difensive. Kur dyshoni, hiqni dorë nga e drejta juaj e përparësisë ose zbrisni nga biçikleta dhe kaloni në trotuar. Aty gjithësesi do t'ju duhet që ta shtyni biçikletën.

### PRANDAJ

- Pozicionohuni gjithmonë në distancë pas një kamioni/autobusi; asnjëherë afër tyre, përpara ose menjëherë mbrapa.
- Një kamioni/autobusi i duhet shumë vend. Ruani distancën.
- Ngiteni biçikletën me shumë kujdes. Kur jeni në dyshim hiqni dorë nga përparësia juaj. Aksidentet e biçikletave me kamione ose autobusë shpesh përfundojnë në vdekje.
- Pranë makinave mund të kaloni vetëm në krahë të djathtë, në qoftë se për këtë ka mjaftueshëm vend.
- Vendosni kontakt vizual me shoferin.

### VIZAT E BARDHA

Këmbësorët, kur janë duke kaluar rrugën, kanë përparësi. Atyre u lejohet që ta kalojnë rrugën, ndërsa të gjitha automjetet, përfshi edhe biçikletat, duhet të presin.

Në rast mosrespektimi, edhe për ato mund të vihen gjoba.







## RREZIQE TË TJERA

Në korsitë e përbashkëta për këmbësorët dhe biçikletat **ecni me biçikletë** me shumë kujdes dhe me aq shpejtësi, sa të mund të frenoni dhe të qëndroni! Shpejtësinë tuaj përshtatëni me këmbësorët.

Përveç kësaj, shoferët e kamionëve edhe mund të mos ju shohin në kryqëzime ose në rrugët hyrëse të trualleve.

Mbani distancë me mjetet që parkojnë, sepse dyert mund të hapen papritur.



## NË RASTIN E NJË AKSIDENTI

Nëse pësoni një aksident, kërkoni ndihmë. Mos u largoni asnjëherë nga vendi i aksidentit pa e raportuar më parë atë. Kjo është e dënueshme.

**Telefoni në numrin e Qendrës së Shpëtimit: 112**

**Ky numër telefoni funksionon edhe kur nuk keni kredite në celularin tuaj.**

**Qendra e Shpëtimit do të bëjë këto pyetje:**

**Ku** ka ndodhur diçka?

**Çfarë** ka ndodhur me saktësi

**Sa** persona janë prekur?

**Çfarë** lloj plagosjeje/emergjence është?


Prisni për pyetjet e tjera!

Prisni ambulancën ose policinë dhe jepni informacionet.

Në qoftë se nuk mundeni të merrni vetë në telefon, tërhiqni vëmendjen e të tjerëve për situatën, me qëllim që të merrni ndihmë.



## Ju levizni me pedelec



Nëse ngisni një pedelec, bëni kujdes që të trajnoheni më parë.

Meqenëse pedelecët kanë mbështetje elektrike deri në 25 km/h dhe mbështetimin e pedalimit, ndonjëherë mund të jeni shumë të shpejtë.

Kohët e reagimit janë të ndryshme nga ato të një biçiklete të zakonshme.



Kur jeni me pedelec, duhet të ecni në korsinë e biçikletave.

Vlejnë të njëjtat rregulla si me biçikletë. Nuk duhet të përdorni trotuarin. Lejohet që të përdorni edhe korsitë e shpejta të biçikletave.

Për të përdorur një pedelec nuk ju nevojitet ndonjë numër sigurimi apo ndonjë moshë minimale.

**Gjithësesi, ju rekomandojmë domosdoshmërisht mbajtjen e një kase.**





## Informacione të tjera:



[www.germanroadsafety.de](http://www.germanroadsafety.de)

Në këtë faqe interneti ju mund ta shkarkoni falas broshurën edhe në versionet e gjuhëve të tjera.



**Publikuar nga:**

Deutscher Verkehrssicherheitsrat (DVR)  
Jägerstr. 67-69  
10117 Berlin  
[www.dvr.de](http://www.dvr.de)

Deutsche Verkehrswacht e.V.  
Budapester Straße 31  
10787 Berlin  
[www.deutsche-verkehrswacht.de](http://www.deutsche-verkehrswacht.de)

Unfallforschung der Versicherer (UDV)  
Wilhelmstraße 43/43 G  
10117 Berlin  
[www.udv.de](http://www.udv.de), [www.gdv.de](http://www.gdv.de)

**Redaksia:**

Olivera Scheibner (DVR), Kay Schulte (DVR),  
Daniel Schüle (DVW), Jörg Ortlepp (UDV)

**Koncepti, faqosja, tekstet:**

P.AD. Werbeagentur, Meinerzhagen  
2022

**Evidenca fotografike:**

[www.dvr.de](http://www.dvr.de)  
[www.shutterstock.de](http://www.shutterstock.de)